



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 korrik 2021
Nr. ref.:RK 1819/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO88/21

Parashtrues

Presidentja e Republikës së Kosovës

**Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës
së Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Vjosa Osmani-Sadriu (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Parashtruesja e kërkesës kërkon: (i) interpretimin e nocionit “grupi më i madh parlamentar” në kontekst të ndarjes së vendeve në Komision Qendror Zgjedhor (në tekstin e mëtejme: KQZ) për grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), në kuptim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); dhe (ii) zgjidhje të konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së.
3. Në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është paraqitur në formë të katër (4) pyetjeve që mund të përmbliidhet si vijon: (i) cili është kuptimi i nocionit të grupit apo grupeve parlamentare në ndërlidhje me fjalën “mund” të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës; (ii) cili është kriteri mbizotërues për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë të KQZ-së duhet të emërohen nga grupi më i madh parlamentar apo nga disa grupe parlamentare, sidomos kur një grup parlamentar ka fituar mbi 50% të votave në zgjedhje; (iii) nëse duhet të reflektohet parimi i proporcionalitetit (numri i deputetëve të një grupi parlamentar në raport me të tjerat) për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë në KQZ i takojnë vetëm një grupi apo disa grupeve parlamentare; dhe, (iv) në rastet kur komunitetet jo shumicë kanë numër të njëjtë të deputetëve, si përcaktohet radha e tyre në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës?
4. Parashtruesja e kërkesës po ashtu kërkon caktim të masës së përkohshme duke arsyetuar: *“[p]ër shkak të rrethanave specifike të shpjeguara në këtë kërkesë, dhe me qëllim të ruajtjes së sigurisë juridike dhe interesit publik, kërkohet vendosja e masës së përkohshme në zbatimin e afateve ligjore (60 ditë nga ditë e certifikimit të rezultatit zgjedhor) , siç parashihet në nenin 61, paragrafin 4, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me fillimin e mandatit të dy anëtarëve të KQZ-së, të cilët nuk janë emëruar në këtë raund për shkak të paqartësive kushtetuese. Nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet sidomos relevante për faktin se brenda këtij viti do të organizohen zgjedhjet lokale, dhe është e domosdoshme që veprimet të cilat ndërmerren nga Presidentja në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 9 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës dhe nën paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si në nenin 31 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenin 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 68 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit] dhe rregullin 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 maj 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 14 maj 2021, parashtruesja e kërkesës, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kryetarja e KQZ-së u njoftuan për regjistrim të kërkesës. Nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës u kërkua që nga një kopje të kërkesës t'ua dorëzojë të gjithë deputetëve dhe grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim që t'i dorëzojnë komentet e tyre me shkrim, nëse kanë, deri më 31 maj 2021.
8. Më 17 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KO88/21, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi si Gjyqtar raportues në vend të Gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.
12. Grupet parlamentare, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës por as Palët tjera të njoftuara, nuk dorëzuan komente lidhur me këtë kërkesë, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata.
13. Më 24 qershor 2021, Kryetari i Kuvendit iu drejtua Gjykatës me kërkesë për shtyrje të afatit për dorëzim të komenteve nga Deputetët e Kuvendit të Kosovës duke shpjeguar se shkresa e 14 majit 2021 nuk u ishte dërguar Deputetëve të Kuvendit për arsye objektive.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 28 qershor 2021, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit të Kosovës se kërkesa për shtyrje të afatit për dorëzim të komenteve nga Deputetët e Kuvendit është paraqitur tri javë pas përmbylljes së afatit për dorëzim të komenteve dhe se e

njëjta refuzohet bazuar në paragrafin 3 të rregullin 33 të Rregullores së punës. Gjykata në praktikën gjyqësore të saj ka refuzuar kërkesat për shtyrje të afatit për dorëzim të komenteve (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO61/20 *parashtrues: Uran Ismaili dhe 29 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 majit 2020, paragrafi 23; dhe KO98/20 *parashtrues: Hajrulla Çeku dhe 29 deputetë*, Vendim për Heqje të Kërkesës nga Lista, i 18 nëntorit 2020, paragrafi 19).

16. Më 2 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe, njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, me shumicë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

17. Më 14 shkurt 2021, janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
18. Më 12 mars 2021, KQZ-ja certifikoi rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve: Lëvizja Vetëvendosje 50.280% (58 ulëse), PDK 17.009% (19 ulëse), LDK 12.731% (15 ulëse), SL 5.094% (10 ulëse), AAK 7.124% (8 ulëse), KDTP 0.745% (2 ulëse), Vakant 0.616% (1 ulëse), IRDK 0.379% (1 ulëse), RI 0.364% (1 ulëse), NDS 0.331% (1 ulëse), SDU 0.292% (1 ulëse), JGP 0.248% (1 ulëse), PAI 0.245% (1 ulëse) dhe LPRK 0.139% (1 ulëse).
19. Më 22 prill 2021, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës kishte dërguar kërkesë tek grupet parlamentare për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së, të cilët më pas do të dekretoheshin nga Presidentja.
20. Më 29 prill 2021, subjekti politik AAK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar një (1) anëtar nga ky subjekt politik në KQZ.
21. Më 5 maj 2021, subjekti politik SDU, që përfaqëson komunitetin boshnjak me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për anëtar të KQZ-së.
22. Më 5 maj 2021, subjekti politik LS, që përfaqëson komunitetin serb me dhjetë (10) deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për anëtar në KQZ.
23. Më 6 maj 2021, subjekti politik IRDK, që përfaqëson komunitetin egjiptian me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për anëtar në KQZ.
24. Më 6 maj 2021, "Koalicija VAKAT", që përfaqëson komunitetin boshnjak me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar propozimin për anëtar në KQZ.
25. Më 6 maj 2021, subjekti politik LDK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndarjen

- e vendeve të rezervuara, ka nominuar një (1) anëtar nga ky subjekt politik si përfaqësues në KQZ.
26. Më 7 maj 2021, subjekti politik NDS, që përfaqëson komunitetin boshnjak me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për anëtar në KQZ.
 27. Më 7 maj 2021, subjekti politik PDK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të merr pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar dy (2) anëtarë nga ky subjekt politik si përfaqësues në KQZ.
 28. Më 11 maj 2021, subjekti politik KDTP, që përfaqëson komunitetin turk me dy (2) deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për një (1) anëtar në KQZ.
 29. Më 12 maj 2021, Lëvizja Vetëvendosje, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili nuk ka të drejtë të merr pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar tre (3) anëtarë nga ky subjekt politik si përfaqësues në KQZ.
 30. Më 12 maj 2021, Presidentja e Republikës së Kosovës emëroi tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Presidentja e Republikës së Kosovës nuk i emëroi dy (2) anëtarë tjerë të KQZ-së për shkak të "paqartësisë" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Kërkesa e parashtrueses së kërkesës

31. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] paragrafi 4, të Kushtetutës. Gjykata rithekson se kërkesa për interpretim e Parashtrueses së kërkesës është paraqitur në formë të katër (4) pyetjeve që mund të përmbliidhet si vijon: (i) cili është kuptimi i nocionit të grupit apo grupeve parlamentare në ndërlidhje me fjalën "mund" të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës; (ii) cili është kriteri mbizotërues për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë të KQZ-së duhet të emërohen nga grupi më i madh parlamentar apo nga disa grupe parlamentare, sidomos kur një grup parlamentar ka fituar mbi 50% të votave në zgjedhje; (iii) nëse duhet të reflektohet parimi i proporcionalitetit (numri i deputetëve të një grupi parlamentar në raport me të tjerat) për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë në KQZ i takojnë vetëm një grupi apo disa grupeve parlamentare; dhe, (iv) në rastet kur komunitetet jo shumicë kanë numër të njëjtë të deputetëve, si përcaktohet radha e tyre në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës?

Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës

(i) Përkitazi me pikën (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës

32. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës bazuar në pikën (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës fillimisht thekson se ajo është e autorizuar të ngre çështje që ndërlidhen me konfliktin e kompetencave ndërinstitucionale. Lidhur me këtë ajo thekson se "Kuvendi i Republikës së Kosovës përbehet nga 120 deputete. Këta deputetet për të funksionalizuar

punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, formojnë grupe parlamentare të cilat ushtrojnë funksionin e tyre brenda ombrellës së Kuvendit. Rrjedhimisht, grupet parlamentare janë trupa përbërëse të Kuvendit të Republikës së Kosovës. E drejta për nominim të anëtarëve të KQZ-së është kompetencë e grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, sipas përcaktimit nga Neni 139, paragrafi 4, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.” Sipas parashtrueses së kërkesës “grupet parlamentare të VV-së dhe PDK-së, kanë propozuar kandidatët e tyre për anëtarë në KQZ, por numri i të propozuarve nuk përkon me numrin e ulëseve të lira për anëtarët e këtyre dy grupeve parlamentare.”

33. Andaj, ajo pretendon se në rastin në fjalë, *“kemi të bëjmë me konfliktin të autorizimeve të grupeve parlamentare (si organe të Kuvendit) për të propozuar kandidatët për anëtarë të KQZ-së, si hap fillestar para emërimit nga ana e Presidentes, si kompetencë kushtetuese e Presidentes. Në këtë rast, si kompetenca e grupeve parlamentare për të propozuar, ashtu edhe kompetenca e Presidentes për të emëruar, janë të parapara në Nenin 139 të Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, që të dyja janë kompetenca kushtetuese.”*
34. Parashtruesja e kërkesës më tej thekson se në rastin KO131/18, Gjykata kishte përcaktuar tri kritere që duhen plotësuar në mënyrë që rasti të konsiderohet i pranueshëm në përputhje me nenin 113, paragrafi 3, nën-paragrafi 1 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, dhe atë që konflikti i kompetencave të: (i) ngrehet nga njëra nga tri palët e autorizuara; (ii) që konflikti të ngrehet për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërin nga tri palët e autorizuara; dhe, (iii) që të ketë konflikt.
35. Rrjedhimisht, parashtruesja e kërkesës thekson se në rastin konkret përmbushen tri kërkesat e ngërthyera në nenin 113 paragrafi 3, nën-paragrafi 1 të Kushtetutës të zberthyera nga Gjykata në rastin nr. KO131/18 sepse: (i) konflikti ngrehet nga njëra prej tri palëve të autorizuara e që është Presidentja e Republikës së Kosovës; (ii) konflikti ngrehet për një kompetencë kushtetuese të caktuar, në këtë rast për nominimin dhe emërimin e anëtarëve të KQZ-së siç parashihet në nenin 139, paragrafi 4 i Kushtetutës; (iii) konflikti ekziston meqë nominimi për anëtarë në KQZ, e cila është kompetencë e grupeve parlamentare si trupa të Kuvendit, i paraprinë emërimin të anëtarëve të KQZ-së, si kompetencë e Presidentes së Republikës së Kosovës; dhe, rrjedhimisht, (iv) rasti në fjalë përmbush tri kriteret e përcaktuara nga Gjykata.

(ii) Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës sipas paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës

36. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës bazuar në nenin 84 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës pohon se: (i) *“sipas Nenit 84, paragrafi 2, të Kushtetutës, një ndër kompetencat e Presidentes është edhe garantimi për funksionimin Kushtetues të institucioneve [...]”*; (ii) Kushtetuta i jep të drejtë Presidentes që të kërkojë interpretim të çështjeve kushtetuese kur kemi të bëjmë me paqartësi rreth frymës së Kushtetutës dhe kjo mbështetet edhe me faktin se e drejta për të referuar çështje kushtetuese, është vendosur nën “ombrellën” e kompetencave të Presidentes bazuar në nenin 84 të Kushtetutës; (iii) kërkesa bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës nuk kufizohet në kërkesa tjera dhe sugjeron për një interpretim të gjerë të kuptimit të çështjeve kushtetuese.

37. Në këtë kontekst, parashtruesja e kërkesës pretendon se: (i) ndarja e numrit të propozimeve të emërimeve të anëtarëve në KQZ nuk rregullohet me ndonjë akt tjetër përveçse me Kushtetutë, çka vërteton se kërkesa është “çështje e pastër kushtetuese”; (ii) praktika e Gjykatës tregon se nocioni “çështje kushtetuese” mund të aplikohet në kuptim të zgjeruar (iii) kuptimi i zgjeruar i nocionit “çështje kushtetuese” është adekuat për t’u aplikuar në këtë kërkesë sepse çështjet e ngritura nuk janë vlerësuar më parë nga kjo Gjykatë apo ndonjë gjykatë tjetër; (iv) çështjet kushtetuese mund të pranohen nga Gjykata edhe kur nuk lidhen me juridiksionin e përcaktuar me nenin 113 paragrafët 1 dhe 2 por edhe me nenin 112 paragrafi 1 dhe për këtë, mes tjerash, citon rastet e Gjykatës nr. KO80/10; KO97/10; KO57/12; KO103/14; dhe KO130/15; dhe, se (v) kjo kërkesë buron nga neni 84 paragrafi 9 i Kushtetutës që parashikon referimin e çështjeve kushtetuese në Gjykatë si një nga funksionet e Presidentes.
38. Andaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se *“kjo kërkesë përmbush kriteret e kërkuara për pranueshmëri të saj edhe në bazë të Nenit 84 [të Kushtetutës]. Së pari, i referohet autoritetit kompetent dhe përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës. Së dyti, kërkesa buron nga Neni 84, paragrafi 9 i Kushtetutës me të cilin parashihet referimi çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese si një nga funksionet e Presidentes.”*

Përkitazi me meritat e kërkesës

39. Lidhur me meritat e kërkesës parashtruesja e kërkesës pretendon se: *“Neni 139 paragrafi 4 i Kushtetutës parasheh se nga cilat grupe parlamentare duhet të propozohen anëtarët në rastin kur janë gjashtë grupe parlamentare të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Ky nen vazhdon edhe në situatën kur kemi më pak se gjashtë grupe parlamentare por nuk përcakton shprehimisht se cilit grup i takojnë anëtarët shtesë. Thënë këtë, fjalia e dytë e Nenit 139, paragrafi 4, i Kushtetutës tregon se “grupi” a “grupet” më të mëdha “mund” të emërojnë anëtarë shtesë.”*
40. Parashtruesja e kërkesës pohon se interpretimi i pyetjeve kushtetuese do të shërbente si referencë edhe për proceset e ardhshme të emërimit të anëtarëve të KQZ-së, së paku për dy arsye: (i) do të saktësonte formulën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së, duke specifikuar kriteret mbizotëruese për emërim të anëtarëve nga “grupi” apo “grupet” më të mëdha në rast se në Kuvend përfaqësohen më pak 6 grupe parlamentare, dhe, (ii) do ta saktësonte formulën në bazë të cilës do të emërohen anëtarët jo shumicë, në rast kur një komunitet i caktuar është i përfaqësuar në Kuvend me numër të barabartë të deputetëve nga subjekte të ndryshme politike.
41. Parashtruesja e kërkesës pohon se interpretimi i Gjykatës Kushtetuese do të ofronte siguri juridike në ndërmarrjen e veprimeve të Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, si dhe njëkohësisht do të ishte në interesin publik duke mundësuar funksionalizim të plotë e pa vonesa të një institucioni të rëndësishëm sikurse KQZ-ja, sidomos duke pasur parasysh faktin se shumë shpejt KQZ pritet të filloj punën lidhur me administrimin e zgjedhjeve lokale.

Përkitazi me caktimin e masës së përkohshme

42. Në lidhje me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, parashtruesja e kërkesës thekson: (i) kërkohet vendosja e masës së përkohshme në zbatimin e afateve ligjore (60 ditë nga dita e certifikimit të rezultatit zgjedhor), siç parashikohet me nenin 61, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me fillimin e mandatit të dy anëtarëve të KQZ-së, të cilët nuk janë emëruar në këtë raund për shkak të paqartësive kushtetuese; dhe, se (ii) nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet sidomos relevante për faktin se brenda këtij viti do të organizohen zgjedhjet lokale, dhe është e domosdoshme që veprimet që ndërmerren nga Presidentja në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

*Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]*

[...]

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

[...]

*Neni 112
[Parimet e Përgjithshme]*

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

[...]

*Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]*

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) Çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(2) Përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kushtetutës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;

(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;

(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;

(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

Neni 139

[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli.

4. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtare më 15 qershor 2008)

Neni 61

Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së

61.1 Kryesuesi i KQZ-së emërohet në pajtueshmëri me nenin 139.3 të Kushtetutës së Kosovës.

61.2 Mandati i Kryetarit të KQZ-së është shtatë (7) vjet duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.

61.3 Neni 139.4 i Kushtetutës së Kosovës parasheh se caktimi i anëtarëve të KQZ-së duhet të bëhet sipas procedurave në vijim:

a) Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit(ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në Emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës;

b) Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben në më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme;

c) Anëtarët e KQZ-së nuk shërbejnë në më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme;

d) Përfundimi i mandatit bëhet në ditën e fundit të muajit kalendarik, në të njëjtin muaj në të cilin ka filluar mandati;

e) Pavarësisht nga pika (d) e këtij paragrafi mandati që përfundon nëntëdhjetë (90) ditë ose më pak para zgjedhjeve ose deri 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, automatikisht zgjatet për 90 ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

61.4 Mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend.

Pranueshmëria e kërkesës

43. Në mënyrë që të vendosë lidhur me kërkesën e parashtrueses së kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kriteret e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe saktësuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

44. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës ku edhe përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me rastet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës, përkatësisht Presidentja.

45. Në bazë të nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës, "[...] Presidenti i Republikës së Kosovës [...] [është i] autorizuar të ngrejë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të [...] Kryeministrit, dhe të rregulloreve të qeverisë, me Kushtetutën;

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

46. Më tej, neni 113, paragrafi 3, i Kushtetutës, përcakton që [...], Presidenti i Republikës së Kosovës [...] [është i] autorizuar të ngrejë çështjet në vijim:

(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;

(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;

(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;

(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

47. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit (9) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], të ndërlidhur me dispozitat e lartcekura, i cili përcakton:

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;

[...]

48. Lidhur me këtë Gjykata fillimisht vëren se bazuar në faktet e këtij rasti, rezulton se (i) më 22 prill 2021, Presidentja e Republikës kishte dërguar kërkesë tek grupet parlamentare për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së; dhe (ii) në mes të datave 29 prill 2021 dhe 12 maj 2021, grupet parlamentare të përfaqësuar në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara, përkatësisht LVV, PDK, LDK dhe AAK, kishin propozuar anëtarët përkatës, ndërsa subjektet politike të cilat mbajnë vende të garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, gjithashtu kishin dorëzuar nominimet e tyre.

49. Presidentja e Republikës së Kosovës, më 12 maj 2021, ka emëruar tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Dy (2) anëtarët e tjerë nuk janë emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, sepse (i) LVV ka propozuar tre (3) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, ndërsa PDK ka propozuar dy (2) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, dhe duke pretenduar “paqartësi” në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës që përcakton se “nëse në Kuvend janë të përfaqësuar më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë”, Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për interpretim të “grupit më të madh parlamentar” në kontekst të dispozitës së lartcekur, përkatësisht nëse vendet e lira në KQZ i takojnë vetëm grupit apo grupeve më të mëdha parlamentare; dhe (ii) komuniteti boshnjak, në strukturën aktuale të Kuvendit, është i përfaqësuar përmes tri (3) subjekteve të ndryshme politike me numër të barabartë të ulëseve në Kuvend, ndërsa në Presidencë janë dorëzuar tri (3) propozime nga ky komunitet, ndonëse të njëjtit i takon vetëm një (1) vend në KQZ. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës gjithashtu pretendon “paqartësi” në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, përkitazi me emërimin e anëtarëve të KQZ-së nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastet kur një komunitet përfaqësohet nga më shumë subjekte politike, por me numër të barabartë ulësesh në Kuvend.

50. Gjykata rithekson se kërkesa për interpretim e Presidentes është paraqitur në formë të katër (4) pyetjeve që mund të përmblihet si vijon: (i) cili është kuptimi i nocionit të grupit apo grupeve parlamentare në ndërlidhje me fjalën “mund” të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës; (ii) cili është kriteri mbizotërues për të

vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë të KQZ-së duhet të emërohen nga grupi më i madh parlamentar apo nga disa grupe parlamentare, sidomos kur një grup parlamentar ka fituar mbi 50% të votave në zgjedhje; (iii) nëse duhet të reflektohet parimi i proporcionalitetit (numri i deputetëve të një grupi parlamentar në raport me të tjerat) për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë në KQZ i takojnë vetëm një grupi apo disa grupeve parlamentare; dhe, (iv) në rastet kur komunitetet jo shumicë kanë numër të njëjtë të deputetëve, si përcaktohet radha e tyre në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës?

51. Lidhur me të lartcekurat, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata:

(i) “interpretimin e nocionit “grupi më i madh parlamentar” në kontekst të ndarjes së vendeve në KQZ për grupet parlamentare të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në kuptim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës” duke u bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës; dhe (ii) “zgjidhje të konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së”, duke u bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës.

52. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës së Presidentes bazuar në (i) paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës; dhe (ii) pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës.

(i) Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës

53. Lidhur me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se Kushtetuta i jep të drejtë Presidentes që të kërkojë interpretim të çështjeve kushtetuese kur kemi të bëjmë me paqartësi rreth frymës së Kushtetutës. Sipas saj kjo mbështetet edhe në faktin se e drejta për të referuar çështje kushtetuese, është vendosur nën “ombrellën” e kompetencave të Presidentes bazuar në nenin 84 të Kushtetutës, kështu duke mos u kufizuar në kërkesa të tjera dhe duke sugjeruar për një interpretim të gjerë të kuptimit të çështjeve kushtetuese.

54. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në rastin konkret janë përmbushur kriteret e kërkuara për pranueshmërinë e saj në bazë të nenit 84 (9) të Kushtetutës. Kjo pasi: (i) ndarja e numrit të propozimeve të emërimeve të anëtarëve në KQZ nuk rregullohet me ndonjë akt tjetër përveçse me Kushtetutë, çka vërteton se kërkesa është “çështje e pastër kushtetuese”; (ii) Kushtetuta i referohet Gjykatës Kushtetuese si autoritetit kompetent dhe përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës; dhe (iii) kërkesa buron nga Neni 84, paragrafi 9 i Kushtetutës me të cilin parashihet referimi çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese si një nga funksionet e Presidentes.

55. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës mban qëndrimin se “paqartësia e kompetencave po i pamundëson Presidentes që ti emërojë të gjithë anëtarët e KQZ-së, si organ i cili i administron dhe menaxhon zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të drejtpërdrejta në Kosovë”.

56. Përkitazi me kompetencën e parashtrueses së kërkesës për të parashtruar kërkesë para Gjykatës duke u bazuar ekskluzivisht në nenin 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata i referohet parimeve të përcaktuara nga praktika e saj gjyqësore në raste të ngjashme.
57. Gjykata thekson se në kontekst të parashtrimit të kërkesave para saj duke u bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës, ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore dhe e cila, ndër tjerash, thekson se mundësia e Presidentit për të referuar çështje kushtetuese në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës. Më saktësisht, paragrafi 9 i nenit 84 të Kushtetutës, nuk mund të shërbejë si bazë e ndarë dhe e pavarur nga neni 113 i Kushtetutës dhe se kompetenca e Presidentit që të “referojë çështje kushtetuese” siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 84 të Kushtetutës duhet të jetë e ndërlidhur me nenin 113 të Kushtetutës. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO79/18, *parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës*, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 72, 74, 77, 78 dhe 82; KO131/18 *parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 6 marsit 2019, paragrafi 90; dhe KO181/18, *parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 13 qershorit 2019, paragrafi 46).
58. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se duke u nisur nga fakti që Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe palët e autorizuar për aktivizimin e juridiksionit të saj, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj (shih, rastin KO79/18, cituar më lart, paragrafi 76).
59. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se neni 84 (9) i Kushtetutës, duhet të ndërlidhet me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, e cila përcakton shprehimisht dhe në mënyrë shteruese çështjet që Presidenti i Republikës mund t’ia referojë Gjykatës Kushtetuese.
60. Prandaj, Gjykata rithekson se neni 84 (9) i Kushtetutës nuk mund të shërbejë si bazë e vetme juridike për parashtruesen e kërkesës për të parashtruar kërkesë për interpretim para Gjykatës Kushtetuese dhe rrjedhimisht, Gjykata gjen se kërkesa e parashtrueses së kërkesës për interpretim të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, është e papranueshme për shqyrtim.

(ii) Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të pikës (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës

61. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Presidentja, në cilësinë e parashtrueses ka ngritur gjithashtu rast të konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes të grupeve parlamentare, si trupa të Kuvendit.
62. Parashtruesja e kërkesës pretendon lidhur me këtë se: “[...] në rastin konkret përmbushen tri kërkesat e ngërthyera në nenin 113 paragrafi 3, nën-paragrafi 1 të Kushtetutës të zbërthyera nga Gjykata në rastin nr. KO131/18 sepse: (i)

konflikti ngrehet nga njëra prej tri palëve të autorizuar e që është Presidentja e Republikës së Kosovës; (ii) konflikti ngrehet për një kompetencë kushtetuese të caktuar, në këtë rast për nominimin dhe emërimin e anëtarëve të KQZ-së siç parashihet në nenin 139, paragrafi 4 i Kushtetutës; (iii) konflikti ekziston meqë nominimi për anëtarë në KQZ, e cila është kompetencë e grupeve parlamentare si trupa të Kuvendit, i paraprinë emërimin të anëtarëve të KQZ-së, si kompetencë e Presidentes së Republikës së Kosovës.[...].”

63. Gjykata i referohet edhe njëherë nenit 113.3.(1) të Kushtetutës që përcakton se Presidenti i Republikës së Kosovës është një nga tri palët e autorizuar që të ngre çështje të “konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës”.
64. Gjykata më tutje i referohet edhe kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 31 [Saktësimi i kërkesës] dhe 32 [Afatet] të Ligjit si dhe rregullin 68 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe nenet 31 dhe 32 të Ligjit] të Rregullores së punës, si dispozita që e konkretizojnë më tutje dispozitën e lartcekur kushtetuese për “konflikt në mes të kompetencave kushtetuese”:

Neni 31
[Saktësimi i kërkesës]

Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar që cenohet drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfarëdo informate të dobishme në lidhje me konfliktin e supozuar në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 32
[Afatet]

Kërkesa e ngritur në bazë të nenit 31 të këtij ligji parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

Rregulli 68
[Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe nenet 31 dhe 32 të Ligjit]

- (1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.3, të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit.*
- (2) Kur parashtron kërkesën në pajtim me këtë rregull, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.*
- (3) Pala e autorizuar duhet të identifikojë aktin, i cili shkel kompetencën e tij/saj dhe dispozitën përkatëse të Kushtetutës, e cila është shkelur nga një akt i tillë.*
- (4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita në të cilën ka filluar konflikti i pretenduar.*
- (5) Sekretariati do të njoftojë autoritetin, akti i të cilit kontestohet. Ata mund të përgjigjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit, përveç*

nëse tregohet arsye e mirë për një kohë më të gjatë dhe nëse zgjatja përkatëse miratohet

65. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton interpretimin e saj përmes praktikës gjyqësore të saj se neni 113.3 (1) i Kushtetutës ngërthen në vete tri kushte të nivelit kushtetues, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, përkatësisht domosdoshmërinë që:
- (i) konflikti të ngritët nga njëra nga tri palët e autorizuara;
 - (ii) çështja të ngritët për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara; dhe,
 - (iii) të ketë një konflikt (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO131/18, cituar më lart, paragrafi 92; dhe KO181/18, cituar më lart, paragrafi 58).
66. Për sa i takon kushtin (i), Gjykata ka theksuar që neni 113.3 (1) i Kushtetutës e autorizon Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë që të ngrenë rast të konfliktit në mes të kompetencave të tyre kushtetuese. Ky autorizim është i ndërsjellë dhe secili prej këtyre palëve të autorizuara mund të ngrenë çështje të konfliktit të kompetencave për njërën apo palën tjetër, duke mos përjashtuar mundësinë e ngritjes së konfliktit kundrejt dy palëve njëkohësisht. Në rastin konkret, kjo kërkesë kushtetuese plotësohet me faktin që kërkesa është parashtruar nga Presidentja, si njëri nga tri palët e mundshme që janë të autorizuara për të ngritur çështje të konfliktit në mes të kompetencave të Qeverisë dhe Kuvendit.
67. Për sa i takon kushtin (ii), Gjykata vëren që neni 113.3 (1) i Kushtetutës përcakton që konflikti mund të ngritët vetëm për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara. Ndonëse Kushtetuta e lë të hapur objektin e konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese, ajo bën një kufizim të rëndësishëm lidhur me atë se konflikti i supozuar i kompetencës kushtetuese duhet të burojë patjetër nga kompetencat kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për Presidentin, Kuvendin dhe Qeverinë. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO131/18, cituar më lart, paragrafi 94 KO181/18, cituar më lart, paragrafi 60).
68. Andaj, në vazhdim Gjykata duhet të vlerësojë nëse, në rastin konkret, është plotësuar kriteri (ii) kushtetues, pra nëse në rastin konkret konflikti i supozuar ngritët për “kompetencë kushtetuese” ndërmjet Presidentes të Republikës, Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës.
69. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesja në kërkesën saj kërkon interpretimin e nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtar emërohet nga deputetët të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë”.

70. Gjykata rikujton po ashtu dispozitat relevante të Kushtetutës që përcaktojnë:

Neni 84

[Kompetencat e Presidentit]

[...]

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

[...]

Neni 139

[...]

[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.

[...]

71. Në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje dispozitën e nenit 61.3.a të Ligjit Nr.03/LO73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili parashikon: “[...] a. Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit (ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individ i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në Emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës.”
72. Gjykata vëren se neni 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës, përcaktojnë kompetencën kushtetuese të Presidentes për emërimin e Kryesuesit të KQZ-së dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij të fundit, por kompetenca e Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së nuk është e përcaktuar me Kushtetutë, por vetëm me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht me pikën (a) të paragrafit 3 të nenit 61 të tij. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KO79/18, cituar më lart, paragrafi 81). Duke marrë parasysh që konflikti i kompetencave, në rrethanat e rastit konkret, është ngritur përkitazi me një kompetencë të Presidentes dhe e cila nuk është përcaktuar me Kushtetutë, Gjykata, bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës dhe praktikës së saj gjyqësore përmes të cilës ka interpretuar këtë dispozitë, thekson se konflikti i kompetencave nuk është ngritur përkitazi me “kompetenca kushtetuese” të Presidentes dhe për pasojë, nuk është plotësuar kriteri i dytë kushtetues në kontekst të ngritjes së “konfliktit të kompetencave” kushtetuese për Presidentin, Kuvendin dhe/ose Qeverinë. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KO131/18, cituar më lart, paragrafët 102-106). Marrë parasysh që kriteri i dytë kushtetues në kontekst të nenit 113.3.1 të Kushtetutës, nuk është plotësuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, konsideron se nuk është e nevojshme të vlerësojë kushtin (iii) të pranueshmërisë së kërkesës, respektivisht, nëse ekziston “konflikti” në mes të kompetencave të Presidentit, Qeverisë dhe Kuvendit. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese: KO181/18, cituar më lart, paragrafi 72).

73. Prandaj në vlerësimin e Gjykatës në rrethanat e rastit konkret, Presidentja e Republikës ndonëse është palë e autorizuar që të ngritë çështje të konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të saj dhe Kuvendit, nuk ka ngritur para Gjykatës konflikt të “kompetencave kushtetuese”, sipas përcaktimeve të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, dhe për pasojë, Gjykata shpall kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës të papranueshme bazuar në nenin 113 të Kushtetutës.

Kërkesa për masë të përkohshme

74. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesja e kërkesës ka kërkuar caktimin e masës së përkohshme “[...] Nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet sidomos relevante për faktin se brenda këtij viti do të organizohen zgjedhjet lokale, dhe është e domosdoshme që veprimet të cilat ndërmerren nga Presidentja në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”

75. Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit, që parashikon:

“1.Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë e nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2.Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale”.

76. Gjykata veçse ka vlerësuar se kërkesa është papranueshme bazuar në nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës dhe rrjedhimisht edhe kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.
77. Gjykata refuzon kërkesën për caktimin e masës së përkohshme.

Përfundim

78. Në seancën shqyrtuese të mbajtur më 2 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi rastin KO88/21, përkatësisht kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës për (i) “interpretimin e nocionit “grupi më i madh parlamentar” në kontekst të ndarjes së vendeve në KQZ për grupet parlamentare të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në kuptim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe (ii) “për zgjidhje të konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së”.

79. Gjykata vëren se bazuar në faktet e këtij rasti, rezulton se (i) më 22 prill 2021, Presidentja e Republikës kishte dërguar kërkesë tek grupet parlamentare për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së; dhe (ii) në mes të datave 29 prill 2021 dhe 12 maj 2021, grupet parlamentare të përfaqësuar në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara, përkatësisht LVV, PDK, LDK dhe AAK, kishin propozuar anëtarët përkatës,

ndërsa subjektet politike të cilat mbajnë vende të garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, gjithashtu kishin dorëzuar nominimet e tyre.

80. Presidentja e Republikës së Kosovës, më 12 maj 2021, ka emëruar tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Dy (2) anëtarët e tjerë nuk janë emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, sepse (i) LVV ka propozuar tre (3) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, ndërsa PDK ka propozuar dy (2) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, dhe duke pretenduar “paqartësi” në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës që përcakton se “nëse në Kuvend janë të përfaqësuar më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë”, Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për interpretim të “grupit më të madh parlamentar” në kontekst të dispozitës së lartcekur, përkatësisht nëse vendet e lira në KQZ i takojnë vetëm grupit apo grupeve më të mëdha parlamentare; dhe (ii) komuniteti boshnjak, në strukturën aktuale të Kuvendit, është i përfaqësuar përmes tri (3) subjekteve të ndryshme politike me numër të barabartë të ulëseve në Kuvend, ndërsa në Presidencë janë dorëzuar tri (3) propozime nga ky komunitet, ndonëse të njëjtit i takon vetëm një (1) vend në KQZ. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës gjithashtu pretendon “paqartësi” në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, përkitazi me emërimin e anëtarëve të KQZ-së nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastet kur një komunitet përfaqësohet nga më shumë subjekte politike, por me numër të barabartë ulësesh në Kuvend.
81. Në kontekst të rrethanave të lartcekura dhe duke theksuar se “paqartësia e kompetencave po i pamundëson Presidentes që ti emërojë të gjithë anëtarët e KQZ-së, si organ i cili i administron dhe menaxhon zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të drejtpërdrejta në Kosovë”, Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me (i) kërkesën për interpretimin e nocionit të “grupit më të madh parlamentar” në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, duke u bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës; dhe (ii) kërkesën për zgjidhjen e konfliktit të “autorizimeve” të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së, duke u bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës.

Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës

82. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së Presidentes për interpretim të paqartësive kushtetuese bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës dhe kërkesën përkatëse për përgjigjen në katër (4) pyetje të parashtruara para Gjykatës dhe të cilat do të reflektohen në tërësi në Aktvendimin për Papranueshmëri që do të publikohet në përputhje me rregullat procedurale në ditët në vijim, Gjykata konstatoi që kërkesa e Presidentes është e papranueshme. Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, duke përfshirë rastin KO79/18, në të cilin gjithashtu është trajtuar një kërkesë e Presidentit të Republikës për interpretimin e paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, ka qartësuar që (i) paragrafi 9 i nenit 84 të Kushtetutës nuk është i pavarur nga neni 113 i Kushtetutës; (ii) paragrafi 9 i nenit 84 dhe paragrafi 1 i nenit 112 të Kushtetutës nuk mund të interpretohen jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës; dhe (iii) bazuar në nenin 113 të Kushtetutës, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës përmes përgjigjes në pyetje të

parashtruara para saj, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj.

Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të pikës (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës

83. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së Presidentes, bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, përkitazi me zgjidhjen e konfliktit të “*autorizimeve*” në mes të “*kompetencës kushtetuese*” të Presidentes dhe “*kompetencës së grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend*” për nominimin e anëtarëve të KQZ-së, Gjykata fillimisht theksoi se neni i lartcekur i Kushtetutës përcakton që Presidenti i Republikës së Kosovës është një nga tri palët e autorizuara që të ngre çështje të “*konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës*”. Kjo dispozitë është interpretuar nga Gjykata përmes Aktvendimeve në rastet KO131/18 dhe KO181/18, duke sqaruar tri kriteret kumulative kushtetuese të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që kërkesat e ngritura në bazë të këtij neni të kalojnë testin e pranueshmërisë. Në rastet e lartcekura, Gjykata kishte sqaruar se në kuptim të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, duhet të plotësohen tri kriteret në vijim: (i) konflikti të ngritët nga njëra nga tri palët e autorizuara; (ii) konflikti të ngritët për “*kompetenca kushtetuese*” të Kuvendit, Presidentit dhe/ose Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe që (iii) të ketë një konflikt.
84. Gjykata vlerësoi se në rrethanat e këtij rasti është plotësuar kriteri i parë kushtetues, sepse kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga Presidentja e Republikës së Kosovës, si njëra nga tri palët e autorizuara. Megjithatë, Gjykata konstatoi se kriteri i dytë kushtetues në kontekst të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, nuk është plotësuar, sepse siç ka sqaruar Gjykata në rastet KO131/18 dhe KO181/18, konflikti i supozuar duhet të burojë nga kompetencat kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për palët e autorizuara. Në rrethanat e rastit konkret, për dallim nga nenet 84 (26), 139 (3) dhe 139 (4) të Kushtetutës, e të cilat përcaktojnë kompetencën kushtetuese të Presidentes për emërimin e Kryesuesit të KQZ-së dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij të fundit, kompetenca e Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së nuk është përcaktuar me Kushtetutë, por vetëm me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht me pikën (a) të paragrafit 3 të nenit 61 të tij.
85. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, Presidentja e Republikës nuk ka ngritur para Gjykatës konflikt të “*kompetencave kushtetuese*”, sipas përcaktimeve të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, dhe për pasojë, Gjykata shpalli kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës të papranueshme bazuar në nenin 113 të Kushtetutës dhe refuzoi kërkesën për caktim të masës së përkohshme bazuar në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 2 korrik 2021, me shumicë votash

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për caktim të masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

